



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 248 Prot.

Tiranë, më 8/2 /2017

VENDIM

Nr. 14, datë 8/2 /2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/ Komiteti Shqiptar i Helsinkit, përfaqësuar nga Znj. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 1440 Prot., datë 13.12.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtarë".

Ankuesi në cilësinë e kërkuarit, me shkresën nr. 502-502/2, datë 27.10.2016 ka kërkuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës t'i vihet në dispozicion informacioni dhe dokumentacioni i disponueshëm si më poshtë vijon:

- a) Nëse institucioni juaj ka hartuar planin vjetor që lidhet me procesin e vendimmarrjes të vitit 2015 dhe 2016, bazuar në nenin 6, pika 1, gërma "b" e Ligjit Nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik". Nëse po lutemi të na përcillni kopje të këtyre planeve.
- b) Cilat janë format dhe mënyrat me anë të të cilave janë bërë publike këto plane vjetore? Nëse publikimi është bërë gjithashtu me anë të internetit, lutemi të na përcillni adresën ndërlidhëse (linkun përkatës).
- c) Listën e projekt-akteve (projektligje, projekt strategji, politika me interes të lartë publik) që janë përfunduar së hartuari nga institucioni juaj brenda periudhës Janar – Tetor 2016. Cilat nga këto projekt-akte i janë nënshtruar procesit të njoftimit dhe konsultimit publik? Për ato projektakte që nuk i janë nënshtruar këtij procesi, lutemi të na informoni mbi arsyet përkatëse.
- d) Kopje të njoftimeve publike për procesin e konsultimit publik që janë bërë për secilin projekt - akt që i është nënshtruar këtij procesi sipas nenit 6/a dhe 11/1 të Ligjit Nr.146/2014, si dhe kopje të njoftimeve për konsultime të drejtpërdrejta dhe takime publike me palët e interesuara sipas nenit 6, pika 2 e këtij ligji, për periudhën Janar-Tetor 2016.
- e) Kopje të ftesave, axhendave, listë prezencave dhe procesverbaleve të mbajtura në takimet publike të organizuara për konsultimin publik për secilin

projektligj/projektstrategji/projektpolitike sipas nenit 18 të ligjit Nr.146/2014, për periudhën Janar-Tetor 2016.

- f) Kopje të përmbledhjeve të rekomandimeve të pranuar dhe arsyeve të mospranimit të rekomandimeve për çdo projekt akt që i është nënshtruar procesit të konsultimit gjatë periudhës Janar-Tetor 2016 sipas nenit 19, pika 3 të Ligjit Nr.146/2014.
- g) Kopje të raportit të transparencës për procesin vendimmarrës të institucionit tuaj për vitin 2015 dhe linkun ku këto raporte janë publikuar sipas nenit 20 të Ligjit Nr.146/2014.
- h) Informacion lidhur me ankesat e palëve të interesuara për cënim të së drejtës për njoftim dhe konsultim publik dhe ecurinë e shqyrtimit të tyre nga Institucioni Juaj, sipas nenit 21 të ligjit Nr.146/2014, për periudhën Janar-Tetor 2016.

Me shkresën nr.5230/ Prot., datë 03.11.2016, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke sqaruar ndër të tjera se: "...Janë miratuar dy akte ligjore, të cilat i janë nënshtruar procesit të konsultimit me palët e interesit. Aktet janë konsultuar me shoqatat e transportit, institucionet e varësisë, (si DPSHTRR), janë publikuar në faqen zyrtare të MTI-së dhe janë dërguar për mendim ministrive të linjës. Në cilësinë e akteve që i nënshtrohen konsultimit publik është miratuar Ligji nr. 10/2016, datë 11.02.2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.8308, datë 18.03.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar. Gjithashtu, është hartuar "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë", i cili është publikuar në faqen e internetit të kësaj ministrie, të Kuvendit si dhe i është dërguar për mendim ministrive të linjës. Në fushën e Transportit Ajror është hartuar projektligji "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë", i cili është publikuar në faqen e MTI-së, si dhe ndërkohë janë në proces marrja e mendimeve të ministrive përkatëse. Lidhur me këtë projektligj, pas publikimit në faqen zyrtare, është shprehur Albcontrol sh.a, si ofrues i Shërbimeve të Lundrimit Ajror dhe sugjerimet përkatëse janë duke u reflektuar gjithashtu. Me qëllim plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga Ligji 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", publikimin e projektakteve MTI e ka realizuar nëpërmjet publikimit në faqen e saj zyrtare. Së fundi, ka përfunduar Draftstartegjia e Transportit e cila i është nënshtruar një konsultimi të gjerë publik dhe ekspertësh të njohur evropianë".

Pas përgjigjes së dhënë nga Autoriteti Publik/ Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, ankuesi pretendon se është cënuar në të drejtën për informim, pasi nuk është informuar lidhur me sa ka kërkuar dhe për këtë arsye ka depozituar ankim pranë Zyrës së Komisionerit. Në këto kushte ankuesi kërkon nga KDIMDP, ushtrimin e kompetencave që ju njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit nga autoriteti publik.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" në të cilin citohet se "Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ...kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve", vlerësoi zhvillimin e një seance dëgjimore përpara marrjes së vendimit përfundimtar. Me shkresën nr. 20/3 Prot., datë 05.01.2017, Zyra e Komisionerit njoftoi palët në një seancë dëgjimore në datën 16.01.2017. Në seancë dëgjimore, pala ankuese dhe përfaqësuesit e Autoritetit Publik paraqitën qëndrimet e tyre lidhur me rastin, duke rikonfirmuar qëndrimet e tyre të reflektuara në aktet shkresore të trajtuara më sipër.

Pas shqyrtimit të ankesës, si dhe pas konsultimit të legjislacionit përkatës rezultoi se, dokumentacioni i kërkuar në pikat e kërkesës së Komitetit Shqiptar të Helsinkit është vendosur pjesërisht në dispozicion të ankuesit. Nga administrimi i provave, rezultoi se dokumentacioni i kërkuar në pikën c) është vënë në dispozicion ndërsa informacioni i kërkuar në pikat a), b), d), e), f), g) dhe h) nuk është vënë në dispozicion të kërkuarit.

Për sa më lart, Zyra e Komisionerit vlerëson se, dokumentacioni i kërkuar përbën informacion publik në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", "informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik" dhe si i tillë, duhet vendosur në dispozicion të kërkuarit Komiteti Shqiptar i Helsinkit, nëse ky informacion disponohet nga Autoriteti Publik.

Theksojmë, se e drejta për t'u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, përfaqësuar nga Znj. , ndaj Autoritetit Publik/ Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 'Për të drejtën e informimit', shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëve shjeve administrative'.

### V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Komitetit Shqiptar të Helsinkit, përfaqësuar nga Znj. , nr. 1440 Prot., datë 13.12.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar në pikat a), b), d), e), f), g) dhe h) të kërkesës (shkresa nr. 502-502/2, datë 27.10.2016), brenda datës 15.2.2017.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot në datë 6.2.2017.

